



Republika e Kosovës  
Republika Kosova · Republic of Kosovo  
Kuvendi · Skupština · Assembly



British Embassy  
Pristina



Republika e Kosovës  
Republika Kosova · Republic of Kosovo  
Qeveria · Vlada · Government

17 qershor 2021, Prishtinë

## Memorandum Mirëkuptimi

### ndërmjet

Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Qeverisë së Republikës së Kosovës, dhe

Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut  
përfaqësuar nga Ambasada Britanike

---

*Kuvendi i Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut të përfaqësuar nga Ambasada Britanike, "Palët".*

*Palët kanë të njëjtat qëllime dhe dëshirojnë të konfirmojnë bashkëpunimin në fushat e interesit të ndërsjellë. Është në interes të të gjitha palëve që përkushtimi i Kosovës ndaj qeverisjes së mirë dhe zhvillimit ekonomik të mbështetet nga struktura publike që janë transparente, profesionale dhe llogaridhënëse.*

### Neni 1

#### Qëllimi

1. Në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi, qëllimi i memorandumit të mirëkuptimit është të mbështesë përpjekjet e përbashkëta për të siguruar emërimin e udhëheqësve të përgatitur, të pavarur dhe profesionalë në institucione dhe organe publike, përmes proceseve rekrutuese transparente dhe të bazuara në meritë.
2. Palët bien dakord për të hyrë në bashkëpunim, që ndër të tjera, do të përfshijë mbështetje për institucionet e Republikës së Kosovës në:
  - a. rivendosjen e besimit në institucionet publike duke avancuar zbatimin e proceseve të rekrutimit, siç përcaktohet me legjislacionin përkatës në fuqi. Në terma konkretë, mbështetja britanike do të ndihmojë në funksionalizimin e sistemit të ri të rekrutimit për kategorinë e lartë

- drejtuese, si dhe monitorimin dhe vendosjen e standardit të ri për proceset e rekrutimit në emërimet publike në Kosovë, dhe
- b. përmirësimin e kapaciteteve të institucioneve publike për të kontribuar drejt arritjes së rezultateve në reformat sfiduese, duke mundësuar politikë-bërje më profesionale, llogaridhënëse dhe transparente, me fokus të veçantë në “vlerën për para”.

## Neni 2 Fushëveprimi

1. Institucionet përkatëse, Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, Këshilli Shtetëror i Pranimit dhe Komisionet e Pranimit sigurojnë zbatimin e duhur të procedurave të parashikuara me legjislacioni përkatës në fuqi.
2. Ambasada Britanike do të mbështesë:
  - a. Projektin e Rekrutimit i cili do të zbatohet nga një partner i jashtëm dhe i cili do të ndihmojë institucionet e Kosovës në proceset rekrutuese; dhe
  - b. Projektin e Monitorimit të Rekrutimit i cili do të zbatohet nga një partner vendor dhe i cili do të monitorojë proceset rekrutuese.
3. Partneri i jashtëm zbatues i Projektit të Rekrutimit, i përzgjedhur nga Ambasada Britanike do t'i ndihmojë institucionet e Republikës së Kosovës: në ndërtimin e sistemit për rekrutimin e kategorisë së lartë drejtuese; dhe në proceset teknike të rekrutimit të pozitive të kategorisë së lartë drejtuese në shërbimin civil, institucioneve të pavarura dhe bordeve të ndërmarrjeve publike.
4. Partneri i jashtëm zbatues do të mentorojë dhe këshillojë zyrtarët dhe institucionet vendore; do të trajtojë komisionet e pranimit; dhe do të rekomandojë praktika të mira të rekrutimit. Kjo mbështetje shtrihet në mentorim dhe këshillim:
  - a) të komisioneve të pranimit në përgatitjen e shpalljeve;
  - b) proceset e filtrimit të aplikacioneve;
  - c) vlerësimin e testeve me shkrim;
  - d) intervistimin e kandidatëve;
  - e) rekomandimin e kandidatëve të suksesshëm; dhe
  - f) mbështetjen e zyrtarëve të emëruar në përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve përkatëse.
5. Në rast se situata e krijuar me COVID-19 vazhdon e tillë ose përshkallëzohet, dhe mundësitë e lëvizjes vazhdojnë të jenë të kufizuara, partneri i jashtëm

zbatues do të ndihmojë proceset teknike të rekrutimit që parashihen në pikën 4, nga distanca.

6. Partneri zbatues vendor i Projektit të Monitorimit të Rekrutimit, i përzgjedhur nga Ambasada Britanike nga radhët e shoqërisë civile përmes një procesi konkurrues, do të monitorojë praktikën e rekrutimit në institucione të ndryshme duke përfshirë edhe ato ku nuk janë të përfshirë ekspertët britanik.

### Neni 3 Detyrimi

1. Palët emërojnë së paku një person përgjegjës për komunikim mes palëve dhe zbatim të këtij memorandumi të mirëkuptimit.
2. Palët bien dakord për një listë të përbashkët të pozitive të larta, rekrutimi i të cilave mbështetet nga Projekti i Rekrutimit. Lista e dakorduar (Shtojca B) përpilohet me institucionin përgjegjës për procesin e rekrutimit. Në varësi të fondeve në dispozicion, listës së dakorduar të pozitive të larta mund t'i shtohen pozita shtesë, ose largohen pozita, bazuar në kërkesën e njëjës prej Palëve, dhe pëlqimin e Palëve tjera.
3. Kuvendi dhe Qeveria e Republikës së Kosovës sigurohen se proceset e rekrutimit në institucione publike janë transparente dhe mundësojnë monitorimin nga organizatat e shoqërisë civile, në veçanti nga partneri zbatues vendor i angazhuar nga projektit të Monitorimit të Rekrutimit.
4. Në pajtim me legjislacionin përkatës, ku është e mundur dhe e aplikueshme, Kuvendi dhe Qeveria e Republikës së Kosovës zotohen të përfshijnë përfaqësues të shoqërisë civile nga organizatat përkatëse edhe si anëtarë paneli në komisionet e pranimit.
5. Kuvendi dhe Qeveria e Republikës së Kosovës zotohen se komisionet e pranimit nuk do të jenë mono-gjinore, dhe se ato do të emërohen me kohë nga institucioni përgjegjës.
6. Kuvendi dhe Qeveria e Republikës së Kosovës duhet të: informojnë institucionet nga lista e dakorduar për angazhimin e Projektit të Rekrutimit, dhe gjitha institucionet tjera për angazhimin e Projektit të Monitorimit të Rekrutimit; dhe të sigurohen se proceset e rekrutimit zhvillohen me kohë, dhe në mënyrë meritore dhe të paanshme.

7. Kuvendi dhe Qeveria e Republikës së Kosovës zotohen se do të ndërmarrin hapat konkret për të inkurajuar dhe rritur numrin e grave në pozita drejtuese në të gjitha nivelet e menaxhimit, duke punuar drejt arritjes graduale të përfaqësimit 50%, siç përcaktohet me Ligjin për Barazi Gjinore.
8. Kuvendi dhe Qeveria e Republikës së Kosovës marrin përsipër të lehtësojnë zbatimin e projektit dhe të sigurojnë që partnerët zbatues: janë të përfshirë në proceset rekrutuese që nga fillimi; kanë qasje në proceset e rekrutimit për pozitat e dakorduara dhe në informacionin e domosdoshëm, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
9. Në rast se partneri i jashtëm zbatues detyrohet të punojë nga distanca për shkak të COVID-19, Kuvendi dhe Qeveria e Republikës së Kosovës marrin përsipër të sigurojnë hapësira brenda ndërtesave nga ndërtuesat e Kuvendit apo Qeverisë që plotësojnë kushtet e distancës sociale për zhvillimin e proceseve rekrutuese.
10. Hapësirat e dedikuara për zhvillimin e proceseve rekrutuese nga distanca, duhet të janë të pajisura me gjithë teknologjinë e nevojshme – kompjuter, kamera, mikrofoni, internet të qëndrueshëm etj. që mundësojnë komunikimin mes partnerit të jashtëm zbatues dhe komisioneve të pranimit gjatë procesit të rekrutimit.
11. Partneri i jashtëm zbatues do të mirëmbajë dhe përditësojë vazhdimisht faqen e internetit [www.kosovoselection.org](http://www.kosovoselection.org) për të informuar mediat dhe palët e interesuara për: listën e proceseve të rekrutimit të mbështetura nga Projekti i Rekrutimit; përbërjen e komisioneve të pranimit; afatet kohore të rekrutimit; rezultatet përfundimtare dhe rekomandimet e proceseve të rekrutimit; Memorandumin e Mirëkuptimit me institucionet e Republikës së Kosovës; datat e trajnimit, dhe çdo informatë tjetër relevante në lidhje me Projektin e Rekrutimit. Kjo faqe e internetit është e hapur për t'u ndërlidhur me faqen zyrtare të institucioneve të Kosovës.
12. Pas çdo rrethi të rekrutimit, partneri i jashtëm zbatues do të sugjerojë një listë të ngushtë të kandidatëve, e cila do t'i ofrohet për shqyrtim komisionit përkatës. Zgjedhja përfundimtare e kandidatit të suksesshëm - nga lista e ngushtë e përpiluar nga komisioni përkatës - do të bëhet nga institucionet kompetente të Republikës së Kosovës.
13. Kuvendi dhe Qeveria e Republikës së Kosovës zotohen të zgjedhin kandidatët më të mirë/të ranguar më së larti nga lista e ngushtë e përgatitur nga komisioni përkatës, duke marrë parasysh rekomandimet e partnerit të jashtëm zbatues.

14. Pas çdo raundi të monitorimit të proceseve rekrutuese që zhvillohen pa ndihmën e partnerit të jashtëm zbatues-ekspertëve britanikë, partneri zbatues vendor ofron rekomandime konkrete institucionit dhe/apo komisionit përgjegjës të pranimit lidhur me procesin e rekrutimit në fjalë. Rezultatet e këtij monitorimi do të publikohen edhe në media dhe në raporte të veçanta të partnerit zbatues vendor.
15. Kuvendi dhe Qeveria e Republikës së Kosovës zotohen se do të shqyrtojnë dhe zbatojnë rekomandimet nga raportet e partnerëve zbatues – të jashtëm dhe vendor dhe në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi, të rishpallin proceset e rekrutimit.
16. Ambasada Britanike në Prishtinë, në partneritet me Kuvendin dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës, merr përsipër që t'ua komunikojë rezultatet e këtyre proceseve dhe projekteve institucioneve relevante dhe publikut të gjerë në mënyrë transparente dhe të drejtë.

#### **Neni 5 Ndërprerja**

1. Palët mund të përfundojnë pjesëmarrjen e tyre në këtë marrëveshje duke i dhënë njoftim me shkrim prej një muaji Palëve tjera, në rrethanat e mëposhtme:
  - a. Dështimit të Palëve për të zbatuar detyrimet sipas këtij memorandumit.
  - b. Mungesës së fondeve për të vazhduar mbështetjen e Projektit të Rekrutimit dhe Projektit të Monitorimit të Rekrutimeve.
  - c. Dështimit të konsiderueshëm nga ana e cilitdo partner zbatues për të përmbushur ndonjë nga zotimet e parapara në këtë memorandum.
  - d. Forca madhore.
  - e. Kur ndodhin ndryshime të cilat, sipas mendimit të Palëve, dëmtojnë në mënyrë të konsiderueshme vlerën e kontributit që cilido nga dy projektet jep drejt qëllimit të dëshiruar.

#### **Neni 6 Mosmarrëveshjet**

1. Çdo mosmarrëveshje eventuale ndërmjet Palëve do të zgjidhet me negociata dhe marrëveshje.

#### **Neni 7 Kohëzgjatja**

1. Ky Memorandum Mirëkuptimi do të zgjasë deri në përfundim të mandatit të Legjislaturës VIII të Kuvendit dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës.

**Neni 8**  
**Kopjet e memorandumit**

1. Memorandumi i nënshkruar në tri kopje identike, një për secilën Palë.

**Neni 9**  
**Hyrja në fuqi**

1. Ky memorandum hyn në fuqi në datën e nënshkrimit në mënyrë të rregullt nga të gjitha Palët.

**Shtojcat**

- Shtojca A Përshkrimi i detyrimeve të dy Projekteve  
(a) Projekti i Rekrutimit, dhe  
(b) Projekti i Monitorimit të Rekrutimit.
- Shtojca B Lista e pozitive të lira të larta të dakorduara


**NË DËSHMI TË KËSAJ**, përfaqësuesit e autorizuar në mënyrë të rregulltë e vendosin nënshkrimet e tyre më poshtë.


Për Kuvendin e  
Republikës së Kosovës

Për Qeverinë e  
Republikës së Kosovës

Për Qeverinë e  
Mbretërisë së Bashkuar  
të Britanisë së Madhe  
dhe Irlandës Veriore  
përfaqësuar nga  
Ambasada Britanike

  
Glauk Konjufca  
Kryetar i Kuvendit

  
Albin Kurti  
Kryeministër

  
Nicholas Abbott  
Ambasador